


**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"IVOCLAR VIVADENT & PARTNERS" sh.p.k**



Neni 1

Krijohet nga zoterinjte:

Altin MELE, shtetas Shqiptar, I biri I Ilos, I dt. 03.07.1971, lindur ne Tirane dhe banues ne Rr. Prokop Myzeqari, P.30/3, Ap.20, Tirane, Shqiperi;
Mirjana BAKIU, shtetase Shqiptare, e bija e Mentorit, e dt.28.01.1976, lindur ne Tirane dhe banuese ne Rr. Mihal Grameno, P.13, Ap.24, Tirane, Shqiperi;
Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "IVOCLAR VIVADENT & PARTNERS" sh.p.k.

Neni 2

Shoqeria e ka seline ne Rr.Sami Frasheri, Pallati "Tekno Projekt", Tirane, Shqiperi.

Neni 3

Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj;

- Hapja e shkollave private per pregatitjen e laboranteve dentare per studente shqiptare apo te huaj;
- Organizimi I seminareve, kurseve te trenimit per laborantet dentare shqiptare apo te huaj.
- Hapja e qendrave te demostrimit apo te trainimit te laboranteve dentare shqiptare apo te huaj.
- Shoqeria mund te kryeje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter qe nuk eshte I ndaluar nga ligji shqiptar dhe qe ka lidhje te mjaftueshme me objektin e aktivitetit te saj.

Neni 4

Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga kontribute ne te holla me vlere 100 000 (njqindmije) leke.

Kapitali themeltar eshte ndare ne 100 kuota secila me vlere te barabarte. Vlera e cdo kuote eshte 1000 leke dhe vlera e tyre eshte shlyer plotesisht nga ortakët e shoqerise. Kuotat e shoqerise zoterohen ne masen 51 % nga ortakju Altin MELE dhe 49 % nga ortakja Mirijana BAKIU.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar, por jo me pak se 10 vjet.

Neni 6

Shoqeria "IVOCLAR VIVADENT& PARTNERS" sh.p.k do te administrohet nga te dy ortaket, Altin MELE dhe Mirjana BAKIU, te cilet do t'i kryejne bashkerisht detyrat e administrimit te shoqerise. Kohezgjatja e detyres se administratorit eshte 3 vjet dhe ai mund te rizgjidhet.

Neni 7

Ortaku i shoqerise ne kete moment, ose ortaket e ardheshem, mund te ushtrojne aktivitetin qe kane ushtruar deri tani, por kursesi ate lloj aktiviteti me te cilin ti beje konkurrence shoqerise.

Neni 8

Viti financiar I shoqerise fillon ne Janar dhe mbyllet ne 31 dhjetor me perjashtim te vitit te pare I cili nuk fillon ne Janar.


Neni 9

Shoqeria do ta ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me dispozitat e parashikuara ne kete akt themelimi, dispozitat e statutit te saj si dhe ne perputhje te plote me gjithë legjislacionin shqiptar ne fuqi.


Lexuar miratur dhe nenshkruar

ORTAKET

ALTIN MELE

Altin Mele


MIRJANA BAKIU

Mirjana Bakiu




STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“IVOCLAR VIVADENT& PARTNERS” sh.p.k

Titulli I
Emertimi – objekti
Selia – kohezgjatja

Neni 1

Eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin e shoqerise “IVOCLAR VIVADENT& PARTNERS” shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 2

Objekti I shoqerise “IVOCLAR VIVADENT& PARTNERS” sh.p.k eshte :

- Hapja e shkollave private per pregtatitjen e laboranteve dentare per studente shqiptare apo te huaj;
- Organizimi I seminareve, kurseve te treinimit per laborantet dentare shqiptare apo te huaj.
- Hapja e qendrave te demostrimit apo te trainimit te laboranteve dentare shqiptare apo te huaj.
- Shoqeria mund te kryeje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter qe nuk eshte I ndaluar nga ligji shqiptar dhe qe ka lidhje te mjaftueshme me objektin e aktivitetit te saj.

Neni 3


Selia e shoqerise “IVOCLAR VIVADENT& PARTNERS” sh.p.k do te jete ne Rr. Sami Frasheri, Pallati “Tekno Projekt”, Tirane, Shqiperi.

Neni 4

Residenca ligjore e ortakeve per cdo raport me shoqerine eshte selia e shoqerise.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise eshte e pakufizuar, por jo me pak se 10 vjet.



Neni 6

Shoqeria mund te krijoje dege apo perfaqesi te saj brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Titulli II

Katpitali shoqeror dhe kuotat

Neni 7

Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga kontribute ne te holla me vlere prej 100 000 (njqindmije) leke..

Neni 8

Kapitali themeltar eshte ndare ne 100 kuota secila me vlere te barabarte. Vlera e cdo kuote eshte 1000 leke dhe vlera e tyre eshte shlyer plotesisht nga ortakët e shoqerise. Kuotat e shoqerise zoterohen ne masen 51 % nga ortakju Altin MELE dhe 49 % nga ortakja Mirijana BAKIU.

Neni 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme, ne rruge trashegimie, ne raste ndarje te pasurise midis bashkeshorteve,ndermjet te paralindurve dhe te paslindurve. Pjeset e kapitalit mund tu transferohen te treteve qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakëve qe perfaqesojne jo me pak se 3 /4 e pjeseve te kapitalit themltar.

Titulli III

Asambleja

Neni 10

Asamblete e zakoneshme dhe te jashtezakoneshme do te thirren nga Administratori, mund te zhvillohen edhe jashte selise se Shoqerise, me ane te letrave te thirrjes te derguara cdo ortakju, ne rezidencen e tyre, qe rezulton nga libri I shoqerise, te pakten 15 dite para mbledhjes se asamblese. Ne letren e thirrjes duhet te tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes se asamblese si dhe lista e problemeve qe do te trajtohen. Ne kete leter do te tregohen edhe vendi, dita dhe ora per mbledhjen e dyte ne rast se e para nuk zhvillohet.

Cdo ortak mund te perfaqesohet ne asamble nga dikush tjeter me ane te nje akti delegimi me shkrim.



Neni 11

Asambleja drejtohet nga administratori I vetem. Ne rast mungese te tij asambleja mund te zgjedhe nje president te saj.

Neni 12

Asambleja e zakoneshme, ne mbledhjen e pare, shqyrton dhe merr vendime mbi bazen e votave qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit te shoqerise. Ajo vendos per ceshtje si emerimi dhe shkarkimi I administratorit, eksperteve kontabel te autorizuar, likuiduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe te kontrollit , miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit, etj. Nese per arsye te ndryshme mbledhja e pare nuk realizohet, ne mbledhjen e dyte te asamblese se zakoneshme vendimet merren me shumice votash te ortakeve prezente ose te perfaqesuar, pavaresisht se sa perfaqesojne ata ne kapitalin e shoqerise.

Neni 13

Asambleja e jashtezakoneshme merr vendime ne mbledhjen e pare me shumice te cilesur (votat perfaqesojne 3/4 e kapitalit te shoqerise). Ne rast se mbledhja e pare nuk zhvillohet per arsye te ndryshme, ne mbledhjen e dyte vendimet merren me shumice votash te ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar, te cilet perfaqesojne te pakten gjysmen e kapitalit shoqeror. Asambleja e jashtezakoneshme vendos per ceshtje te tilla si ndryshimi I statutit, zvogelimi I kapitalit te shoqerise, transferimi I pjeseve te kapitalit tek te tretet, shndrimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne nje forme tjeter, likuidimi etj.

Neni 14

Vendimet e asamblese merren ne formen qe eshte me oportune sipas atij qe kryeson asamblene.

Neni 15

Vendimet e asamblese te marra ne perputhje me ligjin ose me kete Statut detyrojne te gjithë ortaket ekzistues te shoqerise ose ata te ardhshmit.

Titulli IV Administrimi

Neni 16

Shoqeria "IVOCLAR VIVADENT& PARTNERS" sh.p.k do te administrohet nga te dy ortaket, Altin MELE dhe Mirjana BAKIU, te cilet do t'i kryejne bashkerisht detyrat e administrimit te shoqerise. Kohezgjatja e detyres se administratorit eshte 3 vjet dhe ai mund te rizgjidhet.

Neni 17

Administratoret e perbashket te shoqerise kane fuqi te kryejne te gjitha ato veprime te nevojeshme per administrimin normal te shoqerise me perjashtim te atyre fuqive apo te drejtave qe I jane njohur asamblese se ortakeve. Administratoreve te perbashket te shoqerise I perket e drejta e firmes se shoqerise dhe perfaqesimi I shoqerise ne mardhenie me te tretet, madje perfaqesimi I shoqerise ne instancat gjyqesore, administrative etj. Administratoret e perbashket te shoqerise pergjigjen ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjit, te ketij statuti, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Neni 18

Administratoret e perbashket te shoqerise mund te emerojne nje drejtor te ndermarjes tregtare ose nje teknik administrativ.

Neni 19

Shperblimi per administratoret, tej shpenzimeve te ndodhura gjate kryerjes se detyrave normale te administrimit te shoqerise, do te percaktohet nga asambleja e ortakeve.

Titulli V

Kontrolli I ortakeve

Neni 20

Cdo ortak I shoqerise ka te drejte te marre njoftim nga administratoret per kryerjen e puneve te shoqerise dhe te konsultohet me librat e shoqerise.

Titulli VI

Bilanci dhe mjetet



Neni 21

Cdo vit financiar fillon ne Janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor te cdo viti. Ben perjashtim viti I pare I aktivitetit te shoqerise, I cili nuk fillon ne 1 Janar.

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecante te hartuara nga Administratori dhe eventualisht nga eksperte kontabel te autorizuar, miratohen nga Asambleja me shumice votash (shumice qe perfaqeson me shume se 1 / 2 e kapitalit te shoqerise). Miratimi I dokumentave mbi veprimtarine vjetore te Shoqerise behet brenda nje afati prej tre muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

Neni 22

Dividentet

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimit, dhe pas zbritjes prej tij te shpenzimeve te kryera gjate administrimit si dhe te pages se administratorit apo drejtorit te ndermarjes tregtare, si dhe pas zbritjes nga ky fitim I vitit financiar te shumes per fondin rezerve (5 % te fitimit te cdo viti, derisa ky te arrije 1 /10 e kapitalit themeltar), cka ngelet do te ndahet midis ortakeve.

Titulli VII

Prishja dhe likuidimi

Neni 23

Shoqeria priset ne te gjitha rastet e parashikuara nga ligji.

Neni 24

Shoqeria hyn ne likujdim ne momentin e prishjes se saj. Asambleja e ortakeve do te percaktoje modalitetet e likujdimit si dhe do te emeroje nje ose me shume likuidatore.


Likuidimi I shoqerise do te behet siapas dispozitave ligjore.

Titulli VIII

Marredheniet e punes

Neni 25

Mardheniet e punes midis shoqerise dhe te punesuarve do te percaktohen nga kontrata individuale dhe kolektive e punes. Per ato cka nuk parashikohet ne keto kontrata do te zbatohet legjislacioni ekzistues I punes.



Titulli IX
Kompetenca gjyqesore

Neni 26

Cdo mosmareveshje qe mund te linde lidhur me interpretimin e ketij statuti apo akteve te tjera te shoqerise, ose mosmareveshjet qe mund te linden gjate ushtrimit te aktivitetit te shoqerise do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast se ky nuk arrihet kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete gjykata e rrethit Tirane.

Titulli X
Dispozita te pergjithshme

Neni 27

Per ate cka nuk eshte thene shprehimisht ne kete statut do te referohet ne ligjin 7638, dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", Kodin Civil, si dhe ne ligje te tjera shqiptare.

ORTAKET

ALTIN MELE

Altin Mele



MIRJANA BAKIU

Mirjana Baku



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR.4/0/ REP



VERTETIM

Sot ne dt. 7. 06.2003, perpara meje Noterit Publik Eqerem GAXHOLLI, atetar I Dhomes se Notereve Tirane, me zyre prane me ish Ekspoziten "Shqiperia Sot", u paraqiten Personalisht:Z. Altin MELE, I biri I Ilos, I dt. 03.07.1971, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. Prokop Myzeqari, P.30/3, Ap.20, madhor, me zotesi juridike te plote per te vepruar, I panjohur prej meje, per identitetin e te cilit u binda pasi pashe pashaporten me Nr. 0111110 dhe Zj. Mirjana BAKIU, e bija e Mentorit, e dt. 28.01.1976, lindur dhe banuese ne Tirane ne adresen: Rr. Mihal Grameno, P.13, Ap.24, madhore, me zotesi juridike te plote per te vepruar, per identitetin e se ciles u binda pasi pashe pashaporten me Nr. 1627176, te cilet deklaruan se e kane hartuar kete Akt Themelimi jashte zyrave te Noterise me vullnetin e tyre te lire dhe te pavesuar, e nenshkruan perpara meje dhe une Noteri me doren dhe me vulen time vertetoj kete sipas ligjit.

NOTERI

EQEREM GAXHOLLI

